



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 169 Akti**

**Nr. 205 Vendimi**

**Tiranë, më 6.11.2019**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Genta Tafa (Bungo)**  
**Etleda Çiftja**  
**Suela Zhegu**

Kryesuese  
Relatore  
Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtare, z. Branko Hrvatin, në datën 6 nëntor 2019, në selinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Njazi Seferi**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** **Neni G, i Aneksit të Kushtetutës** së Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Germa “a”, e pikës 1, të neni 64, dhe të nenit 65, të ligjit nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi vendimin nr. \*\*\*, datë 1.10.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, shkresat e dërguara me anë të postës elektronike për arsyet e dorëheqjes nga subjekti i rivlerësimit, z. Njazi Seferi, si dhe shkresën e datës 2.10.2019 dhe një tjetër shkresë dërguar me anë të postës elektronike më datë 7.10.2019 nga subjekti i rivlerësimit, i cili kërkon ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Njazi Seferi, gjatë periudhës së procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Në bazë të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Njazi Seferi i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar më datën 17.9.2019, nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët: Genta Tafa (Bungo), Suela Zhegu dhe Etleda Çiftja.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 – 33 të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 – 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues me vendimin nr. 1, datë 24.9.2019, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme, për procedurën e rivlerësimit; si dhe të caktojë kryesues të trupit, komisionere Genta Tafa (Bungo). Të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit.

5. Me anë të postës elektronike<sup>1</sup> Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka filluar procesin e rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti gjithashtu u njoftua me përbërjen e trupit gjykues, të shortuar në datën 17.9.2018 dhe iu kërkua të deklaronte nëse ishte në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

---

<sup>1</sup> E-mail, datë 16.10.2018, ora 17:26, “Komisioni – Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

6. Në përgjigje të *e-mail*-it të dërguar sipas pikës 4 më lart, subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike<sup>2</sup> konfirmon marrjen e këtij *e-mail*-i, dhe në një komunikim tjetër në datën 25.10.2019, ora 14:08, deklaroi se është dakord me trupin gjykues dhe se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

7. Pasi relatori i çështjes kreu një hetim të plotë dhe të gjithanshëm paraqiti para trupit gjykues dhe vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatini, rezultatet e hetimit dhe i rekomandoi trupit gjykues dhe vëzhguesit ndërkombëtar mbylljen e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Njazi Seferi.

8. Në mbledhjen e datës 27.9.2019, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi arriti në përfundimin se provat në lidhje me kriterin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe me vlerësimin profesional kanë nivelin e provueshmërisë, me vendimin nr. 2, vendosi të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Njazi Seferi, dhe ta njoftojë se ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, sipas përcaktimeve të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe të neneve D, DH dhe E, të Aneksit të Kushtetutës.

9. Me anë të postës elektronike<sup>3</sup> subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi mbylljen e hetimit kryesisht dhe kalimin e barrës së provës për të tre kriteret e rivlerësimit. Subjektit të rivlerësimit iu bënë me dije të drejtat që gëzon sipas ligjit për: (i) njohjen me dokumentet e dosjes dhe marrjen kopje të tyre menjëherë pas marrjes së njoftimit; (ii) të drejtën për të thirrur dëshmitar apo marrjen e çdo prove mbështetëse; (iii) të drejtën për të paraqitur shpjegime apo prova me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit, jo më vonë se data 8 tetor 2019. Bashkëlidhur këtij *e-mail*-i subjektit të rivlerësimit iu dërguan: (i) rezultatet e hetimit kryesisht në versionin *word* dhe *pdf*; (ii) analiza financiare në *pdf* dhe *excel*; (iii) pasqyra e shpenzimeve të udhëtimit; dhe (iv) metodika e përdorur në analizën financiare.

10. Subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike<sup>4</sup>, konfirmon marrjen e *e-mail*-it/njoftimit për mbylljen e hetimit kryesisht sipas pikës 9 më lart.

11. Më datën 30.9.2019, ora 13:01, subjekti pas marrjes së dokumentacionit përbërës të dosjes deklaroi se: (i) u njoh dhe mori të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana e tij në *CD*, dhe/apo në formë shkresore (fotokopje) sipas kërkesës së tij; (ii) nuk ka asnjë vërejtje në lidhje me dokumentacionin e tërhequr në Komision; dhe (iii) ky dokumentacion është konform me dokumentacionin e dosjeve që i është vënë në dispozicion sipas inventarit përkatës bashkëlidhur kësaj deklaratë.

12. Subjekti i rivlerësimit me shkresën nr. \*\*\*, datë 2.10.2019, drejtuar Komisionit, në të cilën, ndër të tjera, ka njoftuar se bazuar në pikën 1, të nenit 65, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 27.9.2019 ka paraqitur me shkrim dorëheqjen pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke kërkuar mbarimin e statusit të prokurorit për arsye shëndetësore.

13. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me shkresën nr. \*\*\*, datë 2.10.2019 njoftoi Komisionin se në seancën plenare të datës 1.10.2019, vendosi të miratojë kërkesën për dorëheqje të magjistratit Njazi Seferi, duke deklaruar deklarimin e mbarimit të statusit të subjektit të rivlerësimit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë për Krimet e Rënda. Bashkëlidhur

<sup>2</sup> E-mail, datë 20.10.2018, ora 14:29.

<sup>3</sup> E-mail, datë 27.9.2019, ora 12:28, “Komisioni – Njoftim mbi mbylljen e hetimit kryesisht”.

<sup>4</sup> E-mail, datë 27.9.2019, ora 7:51, “Komisioni – Njoftim mbi mbylljen e hetimit kryesisht”.

kësaj shpikrese ishte një kopje të vendimit nr. \*\*\*, datë 1.10.2019, të Këshillit Lartë të Prokurorisë.

14. Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.10.2019, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në germën “a” të pikës 1, të nenit 64, dhe 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në pikën 1, të nenit 189, të ligjit nr. 115/2016, pasi është njohur me kërkesën për dorëheqjen nga detyra të z. Njazi Seferi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, paraqitur nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 27.9.2019, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ka vendosur: (i) deklarimin e mbarimit të statusit për shkak të dorëheqjes të magjistratit Njazi Seferi, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë; (ii) dorëheqja i jep efektet në datën 31.10.2019; dhe (iii) të njoftohet për këtë vendim z. Njazi Seferi dhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

15. Më tej, subjekti i rivlerësimit, në datën 7.10.2019, dërgoi me anë të postës elektronike<sup>5</sup>, njoftimin me nr. \*\*\* prot., datë 7.10.2019, drejtuar trupit gjykues të Komisionit, në lidhje me përfundimin e hetimit kryesisht për procesin e rivlerësimit të subjektit, afatin e caktuar për procesin e rivlerësimit dhe afatin e caktuar për të dhënë prova, shpjegime me shkrim etj., duke deklaruar: “Bazuar në pika 1 dhe 2, të nenin 65, të ligjit nr. 96/2016, ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, në datën 27.9.2019 kam paraqitur me shkrim dorëheqjen pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke kërkuar mbarimin e statusit të prokurorit. Kjo dorëheqje është paraqitur për arsye shëndetësore. Nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.10.2019, ‘Për mbarimin e statusit të Magjistratit’, është vendosur deklarimi i mbarimit të statusit, për shkak të dorëheqës nga ana ime, aktualisht si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Për sa më sipër, në datën 2.10.2019 kam njoftuar me shkrim edhe institucionin tuaj. Në kushtet kur me vendimin e mësipërm është vendosur për mbarimin e statusit të magjistratit, unë nuk jam më prokuror, për rrjedhojë, as subjekt i rivlerësimit kalimtar. Vlerësoj se edhe marrëdhëniet e mëtejshme si subjekt i rivlerësimit kalimtar me institucionin tuaj duhet të ndërpriten.

*Ju lutem, të vlerësoni këtë njoftim si përgjigje zyrtare në lidhje me afatin e përcaktuar në njoftimin tuaj për paraqitjen e provave, shpjegimeve me shkrimet, për përfundimin e hetimit kryesisht për procesin e rivlerësimit tim, kjo edhe në përputhje me nenin G, pikat 1 dhe 2, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 56, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimin nr. 78, datë 12.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, paragrafi 43.”*

16. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegime të plota në lidhje me vullnetin e shprehur me aktin e dorëheqjes nga statusi i magjistratit sipas nenit 65, të ligjit nr. 96/2016, Komisioni ndërpret procesin e rivlerësimit pa zhvilluar seancë dëgjimore publike me subjektin e rivlerësimit, si të bazuar në ligj, duke mos cënuar transparencën e këtij procesi, i cili në themelin e tij ka nevojën e rikthimit të besimit të publikut tek institucionet e sistemit të drejtësisë.

## **II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

17. Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Njazi Seferi, ka filluar në respektim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4, të nenit 4,

---

<sup>5</sup> E-mail, datë 7.10.2019, ora 16:33.

të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

18. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara për sa më lart, konstaton se:

- i. Subjekti i rivlerësimit është me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë;
- ii. Procesi i rivlerësimit ndaj tij nuk ka përfunduar me vendim sipas pikës 1, të nenit 58, dhe me një nga masat disiplinore respektive sipas nenit 59 “*Konfirmimi në detyrë*”, të nenit 60, “*Pezullimi nga detyra dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit*”, dhe të nenit 61, “*Shkarkimi nga detyra*”;
- iii. Sipas nenit G të aneksit të Kushtetutës subjekti i rivlerësimit, z. Njazi Seferi, ka ushtruar të drejtën për të dhënë dorëheqjen;
- iv. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dorëheqjen pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë më datë 27.09.2019; dhe
- v. Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. \*\*\* datë 1.10.2019 ka vendosur deklarimin e mbarimit të statusit për shkak të dorëheqjes së magjistratit z. Njazi Seferi.

19. Në këto kushte, referuar fakteve të konstatuara më lart, Komisioni çmon se procesi i rivlerësimit për subjektin z. Njazi Seferi duhet të ndërpritet sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit, z.Njazi Seferi humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

20. Sipas nenit G, të Aneksit të Kushtetutës: “*1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.*”

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në vendimin nr. 78, datë 12.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese,

## **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Njazi Seferi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.
2. Ndalimin e emërimit të z. Njazi Seferi si gjyqtar ose prokuror të çdo niveli, anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor të Lartë të Drejtësisë ose Prokuror të Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 6.11.2019.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Genta TAFA (Bungo)**

**Kryesuese**

**Etleda ÇIFTJA**

**Relatore**

**Suela ZHEGU**

**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore  
Olsida Goxhaj*